



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija

**SEJDIU KËRKON NGA KQZ PËRGATITJE SA MË TË MIRA PËR NJË
PROCES ZGJEDHOR KORREKT DHE TË NDESHËM**

02. 06. 2009

Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr.Fatmir Sejdiu priti znj. Nesrin Lushta, Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe z. Xhemajl Peçani, Kryeshef i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me të cilët bisedoi për përgatitjen që po bëhen për zgjedhjet e sivjetme lokale. Sejdiu kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të bëhet gjithçka që është e mundur për të përgatitur një proces zgjedhor korrekt dhe të ndershëm, i cili do t'u garantonte qytetarëve sigurinë e votës së tyre. Presidenti Sejdiu shprehu përkrahjen e plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës për KQZ-në, sidomos në këtë proces zgjedhor. Ai ritheksoi se shumë shpejt do të takohet me përfaqësuesit e partive politike, që të arrihet ujdia për datën e zgjedhjeve lokale. Nga ana e tyre, Lushta dhe Peçani, e njoftuan Presidentin Sejdiu për përgatitjet që po bën KQZ për procesin zgjedhor, si dhe për sfidë me të cilat ballafaqohet ky institucion. Ata po kështu falënderuan Presidentin për përkrahjen e dhënë për punën e KQZ-në.

Presidenca e Kosovës